



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR
TIRANE



Nr. 1940 AKTI

Nr. 3 VENDIMI

V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë, e përbërë prej:

Gjyqtare: Fahrije (BUDO) STRINGA

asistuar nga sekretare gjyqësore Aurora DINE, sot më dt.04.01.2013, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile me nr. 1940 akti, që i përket:

PADITES:

Anna Xheka e bija e Ysenit dhe e Sofijes, dtl.23.02.1970, lindur ne Bilisht Korce e banues ne Durres Rruga “Drejtësia”nr.77/90, përfaqësuar me deklarim gojor nga Av.Spiro Dodbiba me nr.3144 License – ne mungese ne shpalljen e vendimit.

I PADITUR:

Qendra Kombetare e Regjistrimit Tirane perfaqësuar me autorizim nr.3082 Prot. date 16.02.2012 nga znj.Aida Shehi – ne mungese ne shpalljen e vendimit.

PERSON I TRETË:

Shoqeria “MP HEC”shpk me perfaqësues ligjor z.Petrit Kutrolli - ne mungese ne shpalljen e vendimit

OBJEKTI:

-Shfuqizimi i Aktit Administrativ nr.871/2; nr.1179/1 prot. date 26.01.2012 “ Vendim i Drejtorit te Pergjithsherm te Qendres Kombetare te Regjistrimit” ,
-Fshitjen nga regjistri i Q.K.R-se te regjistrimit te aplikimit me numer ceshtje CN 640798-01-12 date 04.01.2012 qe i perket vendimit nr.3 date 30.12.2011 te shoqerise “ Mp-hec” sh.p.k.

BAZA LIGJORE:

Nenet 324 e vijues. 328 dhe 329 te K.Pr.Civile;
Ligji nr.9723 date 03.05.2007 “Per Q.K.R-ne”; Ligji nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”.

V E R E N:

Se paditesja Anna Xheka fillimisht i eshte drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me kerkese padine me objekt:



-Ndryshimi i Aktit Administrativ nr.871/2; nr.1179/1 prot. date 26.01.2012 i Drejtorit të Pergjithsherm te Qendres Kombetare te Regjistrimit , duke e rrezuar ankimin administrativ nr.871 prot. date 16.01.2012 te paraqitur nga z.Petrit Kutrolli dhe pranimin e ankimit administrativ nr.1179 prot. date 20.01.2012 te paraqitur nga znj.Anna Xheka.

-Pezullimi i zbatimit te aktit administrativ te mesiperm.

Ne seancen e pare gjyqesore, eshte pranuar kerkesa e pales paditese per pezullimin e zbatimit te aktit administrativ nr.871/2 prot. date 26.01.2012 te Drejtorit te Pergjithsherm te Qendres Kombetare te Regjistrimit, deri ne perfundimin e gjykimit te ceshtjes.

Gjithashtu ne kete senace eshte pranuar edhe kerkesa e pales se paditur Qendra Kometare e Regjistrimit, per thirrjen si person te trete ne gjykim te Shoqerise "Mp-hec" shpk, me perfaqesues ligjor z.Petrit Kutrolli.

Me kerkesen e paditeses eshte ndryshuar objekti i padise, nga i mesipermi ne : - *Shfuqizimi i Aktit Administrativ nr.871/2; nr.1179/1 prot. date 26.01.2012 " Vendim i Drejtorit te Pergjithsherm te Qendres Kombetare te Regjistrimit" ,*

-Fshirjen nga regjistri i Q.K.R-se te regjistrimit te aplikimit me numer ceshtje CN 640798-01-12 date 04.01.2012 qe i perket vendimit nr.3 date 30.12.2011 te shoqerise " Mp-hec" sh.p.k.

Nga hetimi gjyqësor rezultoi se : Shoqeria "MP HEC" shpk eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e themeluar ne date 23.02.2009 dhe regjistruar ne QKR ne date 26.02.2009 me NIPT K93826001D.

Kjo shoqeri rezulton te kete dy administratore apo dy perfaqesues ligjore z.Petrit Kutrolli dhe Znj.Anna Xheka.

Ortak në shoqërinë "MP HEC" shpk përveç personit juridik shoqërisë "Energy- Albania - Group" sh.p.k, e cila zotëron 50 % të kuotave, pjesën tjetër prej 50 % të aksioneve e zotëron shoqëria " Kutrolli Nima" sh.p.k, përfaqësuar nga Z. Petrit Kutrolli, si ortak dhe administrator .

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë " MP-HEC" sh.p.k, paditesja Anna Xheka eshte emëruar si administratore e shoqërisë, krahas administratorit tjetër Petrit Kutrolli, për një periudhë kohore nga data 26/07/2010 deri në datën 26/07/2015.

Rezultoi ne gjykim se me një vendim nr.3 date 30 Dhjetor 2011, të "Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë " MP-HEC" shpk , paditesja Anna Xheka eshte shkarkuar nga detyra e administratorit, vendim i cili eshte nenshkruar vetem nga administratori tjetër i kesaj shoqerie z.Petrit Kutrolli si perf. i ortakut shoqeria "Kutrolli Nima" shpk.

Nga ana e administratorit tjetër te Shoqerise MP-HEC" shpk z.Petrit Kutrolli, eshte aplikuar prane pales se paditur Q.K.R. ne date 04.01.2012 me nr.ceshtje CN-640798-01-12, per shkarkimin e administratores tjetër znj.Ana Xheka.

Pala e paditur Q.K.R, e ka pezulluar aplikimin, bazuar ne nenin 83 te Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 " Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" , pasi mungon njoftimi dhe marrja dijene per ortakun " Energy Albania", i cili nuk ka marre pjese ne mbledhjen e asamblese se ortakeve date 30.12.2011, ka konstatuar se vendimi date 30.12.2011 eshte marre ne kundërshtim me nenin 15 dhe 16 te statutit te shoqerise "MP-HEC" shpk.

Sipas ketij neni te statutit asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor, ajo mblidhet sa here e shohin te arsyeshme ortaket (50% + 1 e votave), por domosdoshmerisht per te miratuar bilancin vjetor te shoqerise. Asambleja i merr vendimet me 50% e 1 te votave te pergjithshme, pervec rasteve te parashikuara ne statut .



Asambleja vendos për ndryshimet në statut (me 100% të votave), kurse shtimi ose pakesimi i kapitalit për emerimin e organit administrativ për drejtimet kryesore të veprimtarisë së shoqërisë, për pushimin apo rritjen e veprimtarisë i merr vendimet me $\frac{3}{4}$ e votave të përgjithshme.

Sipas nenit 86 të Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortaket me të drejtë vote, që zoterojnë me shumë se 30 për qind të kuotave .

Në lidhje me këtë argumentim citon nenet 87/1, neni 81, pika 1/c, neni 95/6 të ligjit të mesiperm.

Nga ana e Drejtorit të Q.K.R.-se është marrë në shqyrtim kërkesa e z.Petrit Kutrolli, në cilësinë e administratorit të Shoqërisë "MP-HEC" shpk protokolluar në QKR me nr.871 Prot. datë 16.01.2012, me lende: Sqarim për kryerjen e aplikimit në QKR datë 04.01.2012 dhe Vendimin e pezullimit të aplikimit nga QKR-ja datë 09.01.2012.

Nga ana e Drejtorit të QKR-se është konstatuar se arsyeja e pezullimit të aplikimit datë 04.01.2012 nuk qendron pasi vendimi nr.3 datë 30.12.2011, është marrë në përputhje me LSHT, nga ortaku "Kutrolli Nima" shpk so zoterues i 50% të kuotave, përfaqësuar nga z.Petrit Kutrolli.3

Gjithashtu nga ana e Drejtorit të Q.K.R.-se është marrë në shqyrtim ankimi administrativ i protokolluar në QKR me nr.1179 prot. datë 20.01.2012 i paditeses, z.Anna Xheka, në cilësinë e administratores tjetër të Shoqërisë "MP-HEC" shpk e cila ka kërkuar: Refuzimin e cështjes CN-640798-01-12, aplikuar nga z.Petrit Kutrolli, pasi është një aplikim që ka në bazë një vendim asambleje të paligjshëm dhe të fallsiifikuar në përmbajtje dhe në formë.

Pala e paditur Drejtori i Qendres Kombëtare të Regjistrimit, pasi ka shqyrtuar të dy ankimet e pretendimet e administratoreve të kesaj shoqërie, ka konstatuar se arsyeja e pezullimit të aplikimit datë 04.01.2012 me nr.cështje Cn-640798-01-12, është marrë në kundërshtim me nenet 15 dhe 16 të statutit të shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k..

Pala e paditur Drejtori i Qendres Kombëtare të Regjistrimit me vendimin nr.871/2 e 1179/1 Prot. datë 26.01.2012 ka vendosur:

1. Pranimin e ankimit administrativ nr.871 Prot. datë 16.01.2012, paraqitur nga z.Petrit Kutrolli.

2. Mospranimin e ankimit administrativ nr.1179 Prot. datë 20.01.2012 të paraqitur nga znj.Anna Xheka.

3. Ngarkohet sektori i regjistrimit të kryejë regjistrimin e aplikimit datë 04.01.2012, me nr.cështje Cn-640798-01-12.

Në keto kushte Paditesja Anna Xheka i është drejtuar Gjykates, duke kërkuar sipas objektit të padisë të ndryshuar.

Sipas pretendimeve të pales paditese në gjykimin ortaku tjetër i shoqërisë "Energy Albania Group" sh.p.k nuk ka marrë njoftim për zhvillimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithëshme.

Në lidhje me këtë pretendim i referohet nenit 54 të Ligjit "Për QKR" , e cila ka pasur për detyrë para se të rregjistronte aplikimin me Nr. çështje CN 640798-01-12 datë 04.01.2012 të kërkonte :

Plotësimin e të gjitha të dhënave të detyrueshme të kërkuara si dhe dokumentet shoqëruese;



Paraqitjen ne formën e kërkuar te dokumentacionit shoqërues qe vërteton te dhënat e regjistruara.

Sipas paditeses QKR e ka kërkuar në fakt Njoftimin nga aplikuesi Petrit Kutrolli, por faktin e mosmarrjes së njoftimit nga ortaku "Energy Albania Group" sh.p.k e ka konsideruar marrje të tij nga kjo shoqëri, kur nuk ka pasur asnjë element që ta provonte këtë.

Paditësja si në ankimimin e saj administrativ edhe në ankimin në rrugë gjyqesore ka pretenduar se ortaku "Energy Albania Group" sh.p.k nuk ka marrë njoftim për zhvillimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Ndërkohë në Aktin Administrativ Nr. 871/2 ; 1179/1 Prot, datë 26/01/2012 "Vendim i Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit" argumentohet : "... aplikuesi ka paraqitur njoftimin drejtuar ortakut tjetër shoqërisë "Energy Albania - Group" sh.p.k. shoqëruar nga dëftesa postare që konfirmon dërgimin e këtij njoftimi. Dëftesat janë të nënshkruara"

Pikërisht kjo, sipas paditeses nuk është e vërtetë. pasi Dëftesat nuk janë nënshkruar nga marrësi. Njoftimi konsiderohet i kryer kur në dëftesat postare është nënshkrimi i marrësit. Në asnjë vend të dëftesave postare nuk ekziston nënshkrimi në emër të marrësit, ortakut "Energy Albania Group" sh.p.k . Në dëftesat postare është nënshkrimi i punonjësit të postës shqiptare. Nënshkrimi i punonjësit të postës shqiptare konfirmon faktin e marrjes në dorëzim të objektit postar nga posta, por nuk përbën kurrësi konfirmim të marrjes së objektit postar nga marrësi apo pritësi i tij. QKR e ka tjetërsuar në mënyrë të habitëshme këtë element thelbësor dhe ka rregjistruar aplikimin duke përmendur si justifikim pikën 2 të nenit 54 të Ligjit "Për QKR" sipas të cilit "QKR nuk mund të shqyrtojë saktësinë e të dhënave ose vërtetësinë e dokumentave , që i bashkëlidhen aplikimit për rregjistrim".

Në fakt sipas pales paditese, nuk jemi në kushtet e provueshmërisë së saktësisë të të dhënave. QKR nuk i është kërkuar prej saj të vërtetonte saktësinë e nënshkrimit të marrjes njoftim nga ortaku "Energy - Albania - Group" sh.p.k por nëse ky nënshkrim do të ekzistonte në dëftesat postare. QKR i është ankimuar fakti që ky nënshkrim nuk ekziston fare dhe prandaj nuk duhet pranuar aplikimi, çka në mënyrë shumë të habitëshme nuk është marrë fare parasysh nga QKR , përkundrazi është shprehur në vendim me pretendimin tërësisht të pavërtetë: " Dëftesat janë të nënshkruara"

Në lidhje me pretendimin e palës së tretë se i ka dërguar njoftimet në të vetmen adresë që kishte. paditësja pretendoi në gjykim se Administratori Petrit Kutrolli prej dy vitesh nga 2009 - 2010 e dinte që në adresën ku dërgoi njoftimin nuk ishte asnjë person i ortakut "Energy Albania Group" sh.p.k. prandaj dërgesa është tërësisht e qëllimëshme në këtë adresë që të mos merite pjesë ortaku "Energy Albania Group" sh.p.k. në mbledhje. Gjithësesi pavarësisht këtij fakti. njoftimi do të konsiderohej i kryer, kur Petrit Kutrolli të kishte marrë konfirmimin postar të dorëzimit të njoftimit të pritësi apo marrësi. Në kushtet kur ai nuk morri këtë konfirmim nuk mund ta konsideronte të kryer njoftimin.

Me keto pretendime pala paditese pretendon për pranimin e kerkese padise sipas objektit te saj.

Perfaqesuesja e pales se paditur Qendra Kombetare e Regjistrimit ne prapsimet e saj e konsideron kerkese padine te pambeshtetur ne ligj e ne prova. e si e tille kerkoj rrezimin e saj.

GJK - P
TIRAZ

Perfaqesuesja e pales se paditur Q.K.R.prapsoi ne gjykim se për sa i përket pretendimit të palës paditëse se nuk ka nënshkruar marrjen e njoftimit. në bazë të ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për QKR" neni 54, pika 2. QKR-ja nuk mund të shqyrtojë saktësinë e të dhënave ose vërtetësinë e dokumenteve. që i bashkëlidhen aplikimit për regjistrim. Kjo parashikohet edhe ne VKM Nr.506, datë 01.08.2007 "Për procedurat për regjistrimin dhe publikimin në QKR", në pika 23 .

Perfaqesuesja e pales se paditur e konsideroi te ligjshem vendimin e nxjerre prej tyre, object i ketij gjykimi Nr. 871/2 ; 1179/1 Prot. datë 26/01/2012 " Vendim i Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit ". Kjo pasi ne zbatim te ketij ligji, QKR-ja është e detyruar të marrë në dorëzim çdo aplikim. të paraqitur sipas këtij ligji dhe dokumentet që i bashkëlidhen, edhe nëse aplikimi është i paplotë, apo dokumentet shoqëruese të pasakta. Në çdo rast QKR-ja përgjigjet me shkrim. Kjo e drejte parashikohet edhe ne nenin 55, pika 2, sipas te cilit:

"QKR-ja nuk mund të refuzojë regjistrimin, nëse aplikimi është dorëzuar sipas parashikimeve të këtij ligji."

Pra sipas pales se paditur, në bazë të kësaj dispozite nëpunësi i autorizuar i QKR vëren vetëm nëse aplikimi është në përputhje me kërkesat e ligjit , dhe ligji në këtë rast nuk është 9901(sikur pretendohet nga pala apo është theksuar në shkresat e sjella si provë", por është pikërisht ligji 9723, datë 03.05.2007 "Për QKR" dhe këtë saktësim e bën dhe pika 2 e kësaj VKM.

Ne lidhje me pretendimin e pales paditese se prova e sjelle prej saj , "Dergim ankese per verifikim nr.225/3 prot. date 16.05.2012 dhe kthim pergjigje nr.1714/7 prot date 26.04.2012" , është në ndihmesë të procesit, sipas pales se paditur nuk qëndron, pasi këto akte nuk vërtetojnë asgjë lidhur me pretendimet e kësaj pale në proces.

Gjithashtu vete ligji nuk parashikon një kontroll me të lartë administrativ të vendimarrjes së QKR lidhur me funksionet e veta, konkretisht . Neni 3 i ligjit 9723, date 03.05.2007 "Per QKR" "Krijimi dhe statusi", Pika 5.

Sipas pales se paditur QKR nuk është organi kompetent që të marr në shqyrtim vlefshmërinë e një akti apo vendimit të një asambleje.

Në rast se pala paditëse kërkon që gjykata të shprehet lidhur me vlefshmërinë e thirrjes së asamblesë, kjo nuk mund të arrihet në një gjykim ku palë e paditur është QKR, një organ i administratës publike, por organet e shoqërisë, administratori dhe asambleja e ortakëve.

Personi i trete ne gjykim Shoqeria "MP HEC"shpk me perfaqesues ligjor z.Petrit Kutrolli, kerkoj rrezimin e kerkese padise se ngritur nga paditesja Anna Xheka.

Personi i trete ne gjykim e konsideron ngritjen e padise nga Anna Xheka te palegjitimuar prej saj, pasi neni 95/6 i ligjit e kulizon te drejten e ankimit te administratores. Punonjesi i shoqerise eshte nje qytetar dhe jo ortak. Kjo e drejte ligjore per t'ju drejtuar gjykates, sipas tij, i takon vetem ortakut te shoqerise te cilet jane: "Energy- Albania - Group" sh.p.k, e cila zotëron 50 % të kuotave, pjesën tjetër prej 50 % të aksioneve e zotëron shoqëria " Kutrolli Nima" sh.p.k.

Sipas personit te trete deri me sot te dy ortaket e shoqerise nuk kane patur ankesa, apo kundershtrim per vendimin e asamblese se ortakeve nr.3 date 30.12.2011 dhe vendimin administrativ te drejtorit te QKR-se.

Ne prapsimet e personit te trete konsiderohet i pabazuar kerkimi per shfuqizimin e vendimit administrativ Nr. 871/2 ; 1179/1 Prot, datë 26/01/2012 " Vendim i Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit ", perderisa eshte ne fuqi vendimi



nr.3 date 30.12.2011 i Asamblese se Shoqerise, vendim i cili mund te ankimohet vetem nga ortaket e shoqerise.

Me keto prapsime personi i trete kerkon rrezimin e padise se paditeses Anna Xheka.

Lidhur me sa më sipër, gjykata cmon se për zgjidhjen e drejtë të themelit të çështjes objekt gjykimi, është e nevojshme t'i jepet përgjigje pyetjes :

A ka vepruar pala e paditur konform ligjit dhe akteve nënligjore ?

Gjykata pasi bëri një analizë të hollësishme të provave në gjykim cmon se kërkesë-padia duhet rrezuar.

Kjo per sa me poshte:

Përpara shqyrtimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë në prova të kërkesë-padisë, gjykata konstatoi se në bazë të Neneve 35§2/b, 36§1, 42§1, 43§1, 324 dhe 327 të Kodit të Procedurës Civile, çështja objekt gjykimi hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Paditësja i ka bazuar kërkimet e saj ne Ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 "Për QKR", në Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne Kodin e Procedurave Administrative, ne nenin 324 e vijues të K. Pr. Civile .

Gjykata cmon se ligji i aplikueshem ne ceshtjen objekt gjykimi eshte Ligji nr.9723 datë 03.05.2007 "Për QKR", Kodi i Procedurave Administrative nenet 105, 118, si dhe Kodi i Procedures Civile nenet 324 e vijues te tij.

Lidhur me sa më sipër, gjykata çmon se për zgjidhjen e drejtë të themelit të çështjes objekt gjykimi, është e nevojshme t'u jepet përgjigje disa pyetjeve (çështjeve) si vijon:

1. Ç'marrëdhënie juridike është marrëdhënia që përbën bazën e mosmarrëveshjes objekt gjykimi?
2. A legjitimohet si paditese në këtë proces, Anna Xheka?
3. A është nxjerrë konform ligjit akti administrativ objekt gjykimi?

Për sa i përket çështjes së parë të shtruar për zgjidhje në arsyetimin e këtij vendimi, gjatë hetimit gjyqësor rezultoi se Shoqëria "MP HEC" shpk eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar ne QKR ne date 26.02.2009, rezulton te kete dy administratore z.Petrit Kutrolli dhe Znj.Anna Xheka dhe ortak në kete shoqëri "MP HEC" shpk përvec shoqërisë "Energy- Albania - Group" sh.p.k, e cila zotëron 50 % të kuotave, pjesën tjetër prej 50 % të aksioneve e zotëron shoqëria " Kutrolli Nima" sh.p.k, përfaqësuar nga Z. Petrit Kutrolli, si ortak dhe administrator, si dhe me vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë " MP-HEC" sh.p.k. paditësja Anna Xheka eshte emëruar si administratore e shoqërisë, krahas administratorit tjetër Petrit Kutrolli, për një periudhë kohore nga data 26/07/2010 deri në datën 26/07/2015.

Vendimi nr.3 date 30 Dhjetor 2011, i "Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë " MP-HEC" shpk , sipas te ciles paditesja Anna Xheka eshte shkarkuar nga detyra e administratorit, vendim i cili eshte nenshkruar vetem nga administratori tjetër i kesaj shoqerie z.Petrit Kutrolli si perf. i ortakut shoqeria "Kutrolli Nima" shpk eshte marrë ne shqyrtim nga ana e Drejtorit te Q.K.R.-se, i cili pasi ka shqyrtuar te dy ankimet e pretendimet e administratoreve te kesaj shoqerie, me vendimin nr.871/2 Prot. date 26.01.2012 ka vendosur:

I. Pranimin e ankimit administrativ nr.871 Prot. date 16.01.2012, paraqitur nga z.Petrit Kutrolli.



Mospranimin e ankimit administrativ nr.1179 Prot. date 20.01.2012 te paraqitur nga znj. Anna Xheka.

3. Ngarkohet sektori i regjistrimit te kryeje regjistrimin e aplikimit date 04.01.2012, me nr.ceshtje Cn-640798-01-12.

Ne keto kushte Paditesja Anna Xheka i eshte drejtuar Gjykates, duke kerkuar sipas objektit te padise te ndryshuar.

Lidhur me sa me sipër, gjykata konstaton se pjesëmarrja e paditëses ne nje procedure administrative prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ka bërë që të lindë një marrëdhënie juridike administrative. Kjo marrëdhënie, si çdo marrëdhënie tjetër administrative rregullohet nga normat e së drejtës publike dhe më konkretisht për çështjen objekt gjykimi, nga ligji Nr.8485, datë: 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", ligji Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për QKR".

Në marrëdhënien administrative në fjalë kanë marrë pjesë nga njëra anë paditesja Anna Xheka e Shoqeria Shoqeria "MP HEC"shpk dhe nga ana tjetër institucion publik qendror Qendra Kombetare e Regjistrimit. Si rrjedhojë e kësaj marrëdhënie administrative të krijuar, ka lindur edhe mosmarrëveshja administrative, midis paditëses Anna Xheka dhe të paditues Qendra Kombetare e Regjistrimit.

Shkak për lindjen e kësaj mosmarrëveshje administrative, është bërë vendimi nr.871/2 Prot. date 26.01.2012 i Qendres Kombetare te Regjistrimit, që pranon ankimin administrativ nr.871 Prot. date 16.01.2012, paraqitur nga z.Petrit Kutrolli, mospranimin e ankimit administrativ nr.1179 Prot. date 20.01.2012 te paraqitur nga znj. Anna Xheka, si dhe eshte ngarkuar sektori i regjistrimit te kryeje regjistrimin e aplikimit date 04.01.2012, me nr.ceshtje Cn-640798-01-12.

Lidhur me sa më sipër, gjykata thekson se në shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative, gjykata merr në konsideratë vetëm çështjet që kanë të bëjnë me paligjshmërinë e aktit administrativ që kontestohet. Konform Nenit 325 të Kodit të Procedurës Civile: "Padia, sipas nenit 324 të këtij Kodi, mund të ngrihet kur paditësi argumenton se akti administrativ është i paligjshëm dhe se atij i cënohen interesat dhe të drejtat e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, individualisht ose në mënyrë kolektive...". Ky nen i KPrC parashikon shprehimisht se gjykata shqyrton vetëm çështjet që kanë të bëjnë me paligjshmërinë e aktit administrativ dhe jo me çështje që kanë të bëjnë me rregullshmërinë e këtij akti, pasi kjo e fundit është kompetencë ekskluzive e organeve administrative kompetente. Sidoqoftë në rast se parregullsia është shkaktuar si rrjedhojë e shkeljes së ligjit, atëherë gjykata detyrimisht e merr në konsideratë këtë fakt, në mënyrë që të jepet një zgjidhje e drejtë e mosmarrëveshjes që paraqitet në gjykatë për zgjidhje.

Lidhur me çështjen e dytë të shtuar për zgjidhje, nëse legjitimohet paditese në këtë proces, Anna Xheka është pozitive. Mosmarrëveshja administrative ka lindur si rrjedhojë e nxjerrjes së një akti administrative nga QKR-ja pas ankeses se saj.

Konform nenit 324, 325 dhe 331 të Kodit të Procedurës Civile, në gjykatë mund të atakohet vetëm një akt administrativ. Aktet administrative nxirren nga organet administrative. Në rastin objekt gjykimi cilësinë e organit administrativ e ka Q.K.R-ja dhe cilësinë e aktit administrativ e ka vendimi nr.871/2 Prot. date 26.01.2012 i Qendres Kombetare te Regjistrimit. Kuptimi i organit administrativ jepet në Nenin 3 të Kodit të



Procedurave Administrative. Në këtë kuptim Qendra Kombëtare e Regjistrimit si institucion publik qendror, ka cilësinë e organit administrativ.

Për sa i përket çështjes së trete shtruar për zgjidhje, nëse është nxjerrë konform ligjit akti administrativ objekt gjykimi, Urdhri i Ministrisë të Financave me Nr.1186/3.Prot. datë: 11.04.2005, gjykata konstaton se përgjigja për këtë pyetje është pozitive.

Per te dhene nje konkluzion te qarte per ceshtjen objekt gjykimi, gjykata cmon te citoje disa dispozita ligjore qe gjejne zbatim ne ceshtjen tone civile, administrative.

Neni 105 i K.Pr.Administrative - Percaktimi i aktit administrativ individual parashikon shprehimisht: Per qellimet e ketij ligji, do te konsiderohen akte administrative te gjitha vendimet e organeve te administrates publike te cilat krijojne pasoja juridike ne raste individuale.

Neni 118 i K. Pr. Administrative - Aktet administrative relativisht te pavlefshme parashikon shprehimisht: " Aktet administrative do te quhen relativisht te pavlefshme, ne kuptimin e ketij Kodi, kur ato jane nxjerre ne kundershtrim me ligjin, por megjithate nuk jane absolutisht te pavlefshme.

2. Nje akt administrativ relativisht i pavlefshem eshte i ankueshem ne rruge administrative dhe gjyqesore perkatesisht mbi bazen e dispozitave te ketij Kodi dhe te Kodit te Procedures Civile."

Neni 116 i K.Pr.Administrative - Aktet administrative absolutisht te pavlefshme, parashikon shprehimisht:

" Aktet administrative do te quhen absolutisht te pavlefshme, ne kuptimin e ketij Kodi, ne rastet e meposhtme:

- a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar;
- b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;
- c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.

Neni 54 i Ligjit nr.9723 datë 03.05.2007 "Për QKR" parashikon shprehimisht :

"1. QKR asiston aplikantin ne plotësimin e aplikimit dhe verifikon:

- a) identitetin e nënshkruesit dhe faktin nëse është person i autorizuar për të bërë regjistrimin;
- b) plotësimin e të gjitha të dhënave të detyrueshme të kërkuara, si dhe dokumentet shoqëruese;
- c) paraqitjen, në formën e kërkuar, të dokumentacionit shoqërues, që vërteton të dhënat që regjistrohen;
- d) faktin nëse të dhënat e shprehura në formularin e regjistrimit nuk kundërshtojnë, në mënyrë të dukshme, të dhënat që përmbajnë dokumentet, që shoqërojnë formularin;
- e) faktin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk përmban korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tij nuk duket qartë, është e palexueshme apo pengon marrjen e imazhit elektronik;
- dh) nëse emri i zgjedhur mund të regjistrohet;
- e) pagesën e tarifës përkatëse për regjistrim;
- ë) faktin nëse aplikanti ka shlyer sanksionet administrative të dhëna, sipas nenit 74 të ketij ligji.

2. OKR-ja nuk mund të shqyrtojë saktësinë e të dhënave ose vërtetësinë e dokumenteve, që i bashkëlidhen aplikimit për regjistrim."

3. QKR-ja lëshon një konfirmim me shkrim, sipas një formati të miratuar, për çdo aplikim të dorëzuar.

4. Konfirmimi lëshohet sipas formatit të miratuar dhe duhet të tregojë kohën e dorëzimit, numrin rendor të paraqitjes së aplikimit, objektin e aplikimit, listën e dokumenteve të dorëzuara dhe shumën e tarifës së paguar.

5. QKR-ja merr në shqyrtim aplikimet për regjistrim, sipas radhës së paraqitjes së tyre.

6. QKR-ja është e detyruar të marrë në dorëzim çdo aplikim, të paraqitur sipas këtij ligji dhe dokumentet që i bashkëlidhen, edhe nëse aplikimi është i paplotë, apo dokumentet shoqëruese të pasakta. Në çdo rast QKR-ja përgjigjet me shkrim.

VKM Nr.506, datë 01.08.2007 "Për procedurat për regjistrimin dhe publikimin në QKR", në pikën 23 parashikon:

"Kur nëpunësi i autorizuar vëren se aplikimi është në përputhje me kërkesat e ligjit, vlerëson vetëm plotësimin e kërkesave, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 54 të ligjit. Në këtë vlerësim nëpunësi i autorizuar nuk mund të shqyrtojë saktësinë e të dhënave, vërtetësinë e dokumenteve, që i bashkëlidhen aplikimit për regjistrim, apo përputhshmërinë e përmbajtjes së tyre me kërkesat e ligjit në fuqi. Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave të deklaruara ose vërtetësinë e dokumenteve, që i bashkëlidhen aplikimit, mbahet nga personat që kanë bërë deklaratimet ose që kanë hartuar aktin, sipas dispozitave ligjore në fuqi."

Gjykata pasi verifikoi dokumentacionin që shoqëron kërkesën e personit të tretë në aplikimin e çështjes me numër Cn-640798-01-12 konstaton se janë depozituar dokumentet e mëposhtme:

-Formulari i aplikimit ;

-Njoftimi Nr.12, datë 14.12.2011;

-Njoftimi Nr.13, datë 14.12.2011;

-Deftësë për pranimin e objekteve postare, datë 14.12.2011 Nr.346743 Kod-Bar 112000;

-Deftësë për pranimin e objekteve postare, datë 14.12.2011 Nr.357883 Kod-Bar 125301;

-Vendimi Nr.3, datë 30.12.2011 i Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve të shoqërisë "MP-HEC" Sh.p.k.

Rezulton se bashkë me dokumentet shoqëruese në këtë aplikim është paraqitur dhe njoftimi i drejtuar ortakut tjetër shoqërisë "Energy Albania Group" Sh.p.k. shoqëruar nga deftesa postare që konfirmon dërgimin e këtij njoftimi. Këto deftesa janë të nënshkruara.

Në zbatim të nenit 56 të ligjit "Për QKR" aplikanti ka plotësuar brenda afatit ligjor elementet që pengonin regjistrimin, (ka paraqitur njoftimin për ortakun "Energy Albania", i cili nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e asamblesë së ortakëve, dt.30.12.2011, brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj). Bazuar në të njëjtën dispozitë, QKR-ja ka qene e detyruar të kryejë regjistrimin brenda një afati 1-ditor nga data e plotësimit ose ndreqjes së dokumentacionit.

Për sa i përket pretendimit të palës paditëse Anna Xheka se nuk ka nënshkruar marrjen e njoftimit, gjykata vlerëson se në bazë të ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për QKR" neni 54, pika 2, QKR-ja nuk mund të shqyrtojë saktësinë e të dhënave ose vërtetësinë e dokumenteve, që i bashkëlidhen aplikimit për regjistrim.



Kjo e drejte eshte e parashikur edhe ne VKM Nr.506, date 01.08.2007 "Per procedurat per regjistrimin dhe publikimin ne QKR". pika 23. Sipas ketij akti nenligjor kur nepunësi i autorizuar vëren se aplikimi është në përputhje me kërkesat e ligjit, vlerëson vetë plotësimin e kërkesave, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 54 të ligjit. Në këtë vlerësim nepunësi i autorizuar nuk mund të shqyrtojë saktësinë e të dhënave, vërtetësinë e dokumenteve, që i bashkëlidhen aplikimit për regjistrim, apo përputhshmërinë e përmbajtjes së tyre me kërkesat e ligjit në fuqi. Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave të deklaruara ose vërtetësinë e dokumenteve, që i bashkëlidhen aplikimit, mbahet nga personat që kanë bërë deklaratimet ose që kanë hartuar aktin, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Per sa me lart gjykata vlerëson se regjistrimi i çështjes me Cn-640798-01-12, date 13.04.2010, është kryer në përputhje me nenin 54 të ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 "Për QKR", si dhe të VKM Nr.506 date 01.08.2007 "Për procedurat për regjistrimin dhe publikimin në QKR".

Madje pika 6 e Nenit 54 parashikon detyrimin e QKR-se të marrë në dorëzim çdo aplikim, të paraqitur sipas këtij ligji dhe dokumentet që i bashkëlidhen, edhe nëse aplikimi është i paplotë, apo dokumentet shoqëruese të pasakta. Në çdo rast QKR-ja përgjigjet me shkrim.

Edhe pika 2 e nenit 55 të po këtij ligji parashikon detyrimin e QKR-se që mund të refuzojë regjistrimin, nëse aplikimi është dorëzuar sipas parashikimeve të këtij ligji.

Gjykata vlerëson se në bazë të kësaj dispozite nepunësi i autorizuar i QKR-se vëren vetëm nëse aplikimi është në përputhje me kërkesat e ligjit, dhe ligji në këtë rast është pikërisht ligji 9723 date 03.05.2007 "Për QKR" dhe këtë saktësim e bën dhe pika 2 e kësaj VKM e cila citon:

"Me termin "ligj" në këtë vendim do t'i referohemi ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Ndërsa Ligji nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ka si objekt të tij parashikimin e rregullave për themelimin e tregtarit dhe shoqërive tregare, administrimin e tyre, të drejtat dhe detyrimet e themeluesve, të ortakëve dhe aksionarëve, çka do të thotë se dispozitat e këtij ligji, nuk parashikojnë rregulla lidhur me regjistrimin e vendimeve në regjistrin tregtar, pasi këtë rregullim e bën ligji nr.9723 date 03.05.2007 "Për QKR".

Ne keto kushte gjykata vlerëson se pala e paditur Qendra Kombëtare e Regjistrimit ka zbatuar procedurën ligjore për nxjerrjen e vendimit nr.871/2 Prot. date 26.01.2012.

Gjykata vlerëson se vendimi nr.3 date 30.12.2011 i Asamblese së Përgjithshme të ortakëve të shoqërisë "MP HEC" shpk, është në fuqi, nuk është objekt i këtij gjykimi dhe nuk është pasoje e vendimit nr.871/2 Prot. date 26.01.2012.

Per sa me lart gjykata vlerëson se kërkesë padia duhet rrezuar si e pabazuar në ligj e në prova e si e tillë duhet rrezuar.

PER KETO ARSYE :

Gjykata bazuar në nenin 329 të K.Pr.Civile.

VENDOSI:

- -Rrëzimin e kërkesë-padisë.

TIRANE

- Shpenzimet gjyqësore pales paditëse.
- -Kundër vendimit mund të bëhet ankim brenda 15-ditëve nga e nesërmeja e shpalljes në Gjykatën e Apelit Tiranë, për palet ne mungese ky afat fillon nga dita e martjes dijeni për vendimin.
- -U shpall në Tiranë dt.04.01.2013.

SEKRETARE
 ALBORA DINE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
 TIRANE
 GJYQTARE
 FABRIJE (BUDO) STRINGA

Shpenzimet gjyqësore
 Takse padie 12.000 leke

Vendimi mori forme te prere pasi
 nuk u ankimua me dt 15.02 2013
 Tirane me dt 10.02 2013

KANCELAR
 Rudin BAQLI

K / SEKRETARE
 Mimoza CENAJ (LULAJ)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
 TIRANE